



V E N D I M

Nr. 17 Date 25.02. 2010

P Ë R

**FILLIMIN E PROÇEDURAVE TË RISHIKIMIT TË RREGULLORES
SË PROÇEDURAVE TË ÇERTIFIKIMIT TË PRODHIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE NGA BURIMET E RINOVUESHËM**

Në mbështetje të neneve, 8 pika 2, gërma m, dhe 9, të Ligjit nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, nenit 26, pika 2, të Rregullave të Praktikës dhe Proçedurave të ERE-s, miratuar me Vendimin e Boridit të Komisionereve nr.21 date 18.03.2009, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë në mbledhjen e tij të datës 25.02.2010, mbasi shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, për rishikimin e Rregullores së Proçedurave të Çertifikimit të Prodhimit të Energjisë Elektrike nga Burimet e Rinovueshëm

Vendosi :

1. Të fillojë proçedurat për rishikimin e Rregullores së Proçedurave të Çertifikimit të Prodhimit të Energjisë Elektrike nga Burimet e Rinovueshëm.
2. Ngarkohet Drejtoria e Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtoria Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për përpunimin e ndryshimeve në Rregulloren e Proçedurave të Çertifikimit të Prodhimit të Energjisë Elektrike nga Burimet e Rinovueshëm.

Ky vendim hyn në fuqi menjehere.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Kryetari i ERE-s

Bujar Nepravishta